

Bio Stefano Romano

Stefano Romano, (Napoli, 1975) artist, kurator dhe studiues. Praktika e tij artistike eksploron kontradiktat e thella që qëndrojnë brenda realitetit tonë, shpesh i hulumtuar në lidhje me arkitekturën, kontekstet urbane dhe ato sociale. Hulumtimi përkthehet në veprime të përkohshme, performanca, instalacione, punime video apo fotografike, të ndërtuara sipas një strukture gramatikore të aftë të gjenerojë gjithmonë situata të papritura dhe një strukturë kohore fleksibël. Në vitin 2023, mbrojti doktoraturën për arkitekturë pranë Universitetit të Ferrarës dhe në kuadër të kësaj doktrature, filloi punë si profesor pranë Universitetit Polis në Tiranë, në fakultetin e Artit dhe Dizajnit. Prej më shumë se njëzet vitesh punon në Shqipëri ku ka konceptuar disa projekte si artist dhe kurator. Ka konceptuar projektin 1.60 insurgent space, fokusi i të cilit është hapësira publike, gjithashtu bashkëthemelues i T.I.C.A. (Instituti i Artit Bashkëkohor Tiranë). Në vitin 2012 ishte bashkëthemelues i DZT (DyZeroTre) dhe platformës MAPS – Mobile Archive on Public Space. Projekti i tij i fundit është The Mobile School of Visual Arts, një projekt pedagogjik, i bazuar tek ideja e artit si prodhim njohurish dhe pjesëmarrje aktive.

Puna e tij është ekspozuar në ekspozita dhe muze kombëtarë dhe ndërkombëtarë, duke përfshirë: Fondazione Pini (Milano, Italia), Collezione Giuseppe Iannaccone (Milano, Italia), Rotor (Graz, Austria), Autostrada Bien-nale (Prizren, Kosovo); BACO arte contemporanea (Bergamo, Italy); Artopia Gallery (Milano, Italia); Ca-reof (Milano, Italia); Placentia Arte (Piacenza, Italia); GAMeC area Palestra, (Bergamo, Italia); Galleria Alice & altri lavori in corso (Roma, Italia); 54° Biennale di Venezia – Padiglione delle Accademie di Belle Arti, Arsenale (Venezia, Italia); Macro Future (Roma Italia); GC.AC (Monfalcone, Gorizia, Italia); Neon campo base (Bologna, Italia); Triennale (Milano, Italia); Chelsea Art Museum (New York, USA); Tirana Bienale3 (Tirana, Albania); Museo d'arte Contemporanea di Villa Croce (Genova, Italia); The Yugoslav Biennial of Young Artist, Centre for Contemporary Arts (Vrsac/Belgrade Serbia e Montenegro); Via Farini (Milano, Italia); Boston Cyberarts Festival, Coolidge Corner Theatre (Boston U.S.A).